



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 29

Datë: 18. 03. 2021. Ora: 13:00

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së KQZ-së Nr.19, 20 dhe 21/2021.

Aktivitetet e SKQZ-së

4.Aktivitetete e ZRPP-së:

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për publikim të dosjes për Informim Publik për zgjedhjet për Kryetar Komune në Podujeve dhe Mitrovicë të Veriut

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për Çregjistrim të Partive Politike që tashmë janë pezulluar

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për Regjistrim të Partisë Politike Partia Republikane për Ndryshim

- Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit mbi Caktimin e Lartësisë së Mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për periudhën nga 1 mars 2021 deri me 31 dhjetor 2021

5.Raporort i Këshillave të KQZ-së:

5.1.Këshilli për Operacione Zgjedhore:

- Shqyrtimi dhe miratimi i “Punëtorisë për Mësimet e Nxëna për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2021 dhe hartimi i draftit të parë të Planit të Punës i KQZ-së për vitin 2021”

5.2.Këshilli për Çështje Ligjore

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kuvendit Komunal në Rahovec dhe Ferizaj

5.3.Këshilli për Buxhet dhe Financa

-Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit për “Punëtorin për Mësimet e Nxëna për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2021, dhe hartimi i draftit të parë të Planit të Punës i KQZ-së për vitin 2021”.

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:

Valdete Daka: E hapi mbledhjen e 29-të, a kemi edhe ndonjë pikë tjetër...?

Alim Rama: Kisha sygjerue që mun ndërrue pika 5.3 me pikën 5.2 !

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së KQZ-së Nr.19, 20 dhe 21/2021

Miratohen, me vërejtje rreth vonesës në aspektin e përpilimit me kohë.

3. Aktivitetet e SKQZ-së

Burmi Ahmetaj: Sekretariati, po kryen një seri të aktivitetëve. Është në draftimin e planit të punës 2021, që i paraprind edhe procesi i zbatimit të planit të vitit të kaluar 2020! Janë edhe 3 aktivitete që nuk janë të paguara ende stafi jo permanent, jemi në procesin e kthimit të materialit nga depoja në QNR, s'i dhe të skanim të të gjitha vendotimeve që ju kanë nënshtruar rinumërimit.

Po ashtu, jemi edhe në procese të tjera të VV, dhe identifikimin e rasteve të caktuara. Kurse, ato vendotime që nuk janë pjesë e hetimit, ato duhet marrë vendim nga KQZ të asgjësohet materiali i procesit zgjedhor të këtij viti.

Kemi dërgua një shkresë Prokurorisë së Shtetit, sepse kemi parashkrimin absolutë të kutive që janë ruajtur nga vitit 2010/11, dhe sapo ta marrim konfirmimin se si të veprojmë me rreth 900 kuti që tashmë kanë parashkrimin absolut, do të fillonim me asgjësimin. Vetëm kutitë nga vitit 2012 – 2019, do të ruhen nga KQZ.

Aktivitet tjetër është që KQZ ka marrë vendim për disa pasuri materiale që një pjesë e tyre mund të jepen donacion, dhe për UVsprejat që një pjesë e tyre kemi vendim të asgjësohen. Nuk kemi marrë hap konkret. Një pjesë e materialit mund të shiten në ankand për hekur...! Të gjitha këto proceseve, duhet tu paraprijë një procedurë e KQZ-së në mënyrë që të fillojmë. Zyra ligjore, po e përgatitë draftin dhe, do ta sjellim në mbledhjen.

Do të na duhet të shohim ende se, a kemi materiale të tjera që duhet t'i nënshtrohen asgjësimit...

Alim Rama: Pse, ne për shembull edhe njëherë duhet të marrim vendim për materialin për hekur, ose të tjerat.

Burim Ahmetaj: Nuk kemi pasur procedurë të tjetërsimit të pasurisë, vec në vitin 2013 kemi pasur asgjësim të UV sprejit.

Alim Rama: Letra që asgjësohet – riciklohet për shembull, s'i bëhet ajo: po më duket falet...? Por, ajo a duhet...

Burim Ahmetaj: Procedurat, na i rregullojnë mënyrat qysh të veprojmë...? Deri tani, nuk kemi pasur procedura...

Sami Kurteshi: Çka është materiali i sprijave, duhet të largohet ! Por, çka bëhet me materialin hekur...! Çka falim...?

Burim Ahmetaj: Për donacion i kemi rreth 1000 tableta që i kemi blerë në 2013. Tani, në 2020 kemi blerë tableta të rinjë për shkak të sistemeve të reja operative. Tabletat e kaluar, tash e kanë vlerën zero, por janë teknologji e vjetruar. Materiali hekur përfshinë materiale të tjera...janë do karroca, kompjuterë...Ne, s'kemi tjetër procedurë si me e hedh në anakand...Për vendim nuk duhet, por procedura duhet miratuar...

4.Aktivitetete e ZRPP-së:

Yll Buleshkaj: Janë disa pika para jush! Të shkojmë me radhë:

1.Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për publikim të dosjes për Informim Publik për zgjedhjet për Kryetar Komune në Podujeve dhe Mitrovice të Veriut.

Yll Buleshkaj: Sipas ligjit, KQZ krijon dosje që përfshinë për secilin subjekt politik, raportin e donatorëve, dhe formularët e publikimit financiar për kandidat për kryetar komune.

Raportet janë krijuar, auditimi ende nuk është bërë por, ne rekomandojmë për publikim. Ne, kemi analizuar dhe përgatitur çdo gjë që duhet...

Arianit Elshani: Kisha dashur që ta respektojmë rregulloren dhe këto, të vijnë edhe të trajtohen edhe në këshillin për çështje ligjore. Ne, mirë është të shohim përmbajtjen e tyre në aspektin ligjorë...! Këtë kërkesë, e kam pasur edhe më herët...

Eshref Vishi: Në pjesën e dytë, te publikimi financiarë. Në procesin e auditimit, këto mund të pësojnë ndryshme. A është në përputhje me ligjin ky tekst...?

Yll Buleshkaj: Po, është në përputhje me ligjin. Është vendim i KQZ-së, e kemi trajtuar pse mund ti publikojmë para se të auditohen...

Në këtë pikë, diskutoi edhe Sami Hamiti, Valdete Daka, Eshref Vishi, Alim Rama.

Miratohet rekomandimi.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për Çregjistrim të Partive Politike që tashmë janë pezulluar.

Yll Buleshkaj: Ky rekomandim, ka të bëjë me çregjistrimin e dy partive politike për mos dorëzim të formularit të azhurnimit vjetor! Bëhet fjalë për dy parti që janë pezulluar nga KQZ para 20 ditësh. Ato, nuk

kanë reaguar edhe pse ne i kemi paralajmëruar. Janë: Partia “Nova Partia Kosova” dhe “Narpedna Stranka Kosova”.

Të dy këto parti, u çregjistruan me vota unanime duke votuar veç e veç nga anëtarët e KQZ-së.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për Regjistrim të Partisë Politike Partia Republikane për Ndryshime:

Yll Buleshkaj: E kemi aplikimin. Nuk ka pengesë dhe ne, rekomandojmë për regjistrim. Është partia nr. 48.

Valdete Daka: Kush është për regjistrim të këtij subjekti?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të ZRPP-së.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit mbi Caktimin e Lartësisë së Mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për periudhën nga 1 mars 2021, deri me 31 dhjetor 2021:

Yll Buleshkaj: Ne, e kemi pasur një vendim për dymujorin e parë, kurse mbas certifikimin e rezultateve, ne mund të procedojmë më tutje. Tani, rekomandimit për periudhën nga 1 mars 2021, deri me 31 dhjetor 2021 llogaritë janë bërë në financa...

Miratohet rekomandimi.

Yll Buleshkaj: E keni edhe një njoftim për kuvendin e LDK-së. Është vetëm njoftim...

5.Raporort i Këshillave të KQZ-së:

1.Këshilli për Operacione Zgjedhore:

Shqyrtimi dhe miratimi i “Punëtorisë për Mësimet e Nxëna për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2021 dhe hartimi i draftit të parë të Planit të Punës i KQZ-së për vitin 2021”:

Alim Rama: E kemi trajtuar në mbledhjen e këshillit mbajtjen e një punëtorie për mësimet e nxëna për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2021, s’i dhe në punëtori do të hartohet edhe drafti i planit të punës së KQZ-së për vitin 2021.

KQZ-i, çdo gjë e ka trajnuar në detaje. Sekretariati ka bërë ndryshimet e nevojshme të rekomanduara nga këshilli. Ne, rekomandojmë për aprovim.

Sami Kurteshi: Është planifikuar të mbahet prej 30 mars – 03 prill. Janë 5 ditë, pak s'i gjatë... Mbahet në Tiranë...! A nuk ka pasur mundësi me u mbajta në Kosovë. Janë disa çështje ekonomike...

S'i ka qenë marrja e vendimit për lokacionit, kohëzgjatja dhe çështja e mëditjeve...?

Sami Hamiti, dhe shpjegime lidhur me këto pyetje.

Valdete Daka: Sa është numri i lejuar sepse, atje janë masat e covidit ? Numri po më duket i madh: 35 persona...?

Sami Hamiti, tha se në Shqipëri nuk ish i kufizuar numri, varësisht nga hapësira e lokalit...

Alim Rama: Buxhetin duhet me shqyrtuar...?

Sami Hamiti, dha shpjegime duke theksuar se, buxheti është i planifikuar...kostoja financiare sipas kodeve të buxhetit

Në këtë pikë, diskutuan më tutje: Eshref Vishi, Alim Rama, Burim Ahmetaj.

Diskutimet, u zhvilluan lidhur me përgatitjet, nevojën praktike të mbajtjes së punëtorive, s'i dhe me çështjet funksionale të KQZ-së.

Miratohet mbajtja e punëtorisë, dhe çështja e buxhetit për punëtorinë: veç e veç...

2. Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kuvendit Komunal në Rahovec dhe Ferizaj

Arianit Elshani: Këshilli, ka shqyrtuar dy kërkesa për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale: në Rahovec dhe Ferizaj. Të dy kërkesat, kanë kaluar filtrat e nevojshëm administrativ dhe procedurat e nevojshme ligjore. Ne, rekomandojmë për aprovim të këture zëvendësimeve.

Valdete Daka: Kush është për që Ridvan Nebihu të emërohet anëtarë i Kuvendit Komunal në Ferizaj nga subjekti politik LDK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm, Burim Karameta.

Aprovohet ky zëvendësim.

Valdete Daka: Kush është për që Kajtaz Berisha të emërohet anëtarë i Kuvendit Komunal në Rahovec nga subjekti politik PDK, duke e zëvendësuar anëtarin e deritashëm, Qazim Ceskaj.

Aprovohet ky zëvendësim.

